

**Njoftim për përqendrim me të cilin ALPE V, shoqëri për investime, sh.p.k, Slloveni do të fitojë kontrollin mbi SANOVET, ambulancë veterinare, shërbime dhe tregti, sh.p.k., Slloveni
(lënda nr. 08-35/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 12.02.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka pranuar një njoftim për përqendrim me të cilin ALPE V, shoqëri për investime, sh.p.k., me seli në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes shoqërisë së saj të lidhur STACIONI VETERINAR SHMARJE PRI JELSHAH sh.p.k., me seli në rrugën Rogashka 46, 3240 Shmarje pri Jelshah, Slloveni do të fitojë kontrollin mbi SANOVET, ambulancë veterinare, shërbime dhe tregti, sh.p.k., Jesenice me seli në Murova 1, 4270 Jesenice, Slloveni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

ALFI PE është menaxheri më i madh i kapitalit privat me seli në Slloveni. Ai menaxhon 2 fonde investimi private: ALFI PE sh.p.k., SIS k.d. dhe ALFI PE Grout SIS sh.p.k. k.d. ALPE V, shoqëri për investime, sh.p.k është në pronësi 100% të ALFI PE sh.p.k., SIS k.d. dhe është Shoqëri me qëllime të veçanta që zotëron pjesë në kompani veterinare brenda Grupit ALFI.

Veprimtaria e regjistruar e ALPE V, shoqëri për investime, sh.p.k është: aktivitete këshilluese lidhur me punën afariste dhe çështje të tjera të menaxhimit.

Grupi ALFI aktualisht ka 1 shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Shoqëri për tregti dhe shërbime APOLLO MK SHPKNJ Shkup me NUAS 6577857 me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 13 Shkup me veprimtari prioritare 46.49 - tregti me shumicë me mallra të tjera shtëpiake.

SANOVET, ambulancë veterinare, shërbime dhe tregti, sh.p.k., Jesenice kryen kontrolle klinike, vaksina dhe trajtime, si dhe diagnostikë laboratorike për kafshë të vogla dhe të mëdha, operacione të indeve të buta te kafshët si sterilizime, kastrime dhe procedura të tjera, dhe është e specializuar edhe për procedura orale te qentë dhe macet si pastrimi i dhëmbëve dhe terapi e mishrave të dhëmbëve.

SANOVET, ambulancë veterinare, shërbime dhe tregti, sh.p.k., Jesenice nuk ka subjekte të lidhura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, as nuk ka realizuar qarkullim në vitin 2023 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi konsideron se tregjet relevante të mallrave për këtë njoftim mund të përcaktohen si treg i shërbimeve veterinare.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën. Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail:

kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet t'i arrijnë Komisionit brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

14.02.2025

Shkup